



Të nderuar prindër,

ka ardhur momenti: Fëmija juaj së shpejti do të shkojë në shkollë. Për ju dhe fëmijën tuaj fillon një pjesë e re e jetës. Shpesh lindin pyetje ose ekzistojnë paqartësi në lidhje me fillimin e shkollës. Në mënyrë që ju të mos mbeten vetëm me pyetjet tuaja, skuadra jonë e përbërë nga mjekë/e shkollorë dhe punonjës të kualifikuar të mjekësisë sociale dëshiron t'ju ndihmojë juve dhe fëmijën tuaj në këtë periudhë të rëndësishme.

Ju lutemi ejani me fëmijën tuaj.....tek ekzaminimi i pranimit në shkollë

me	në orën	në
----	---------	----

Ju lutemi sillni me patjetër me vete dokumentet e mëposhtme për të kryer ekzaminimin:

- **fletoren e vaksinave** (Paraqitja e certifikatave të vaksinimit dhe vërtetimeve të vaksinimit është e detyrueshme në përputhje me nenin 12, pika 3, fjalia 5 GDG (Ligji për shërbimin shëndetësor))
- **kartën e pjesëmarrjes nga fletorja e verdhë e ekzaminimeve, fletoren e verdhë ose një vërtetim mjekësor për kryerjen e ekzaminimeve për detektim të hershëm** (sipas nenit 12, pika 3 GDG)
- **këtë formular me pjesën e pasme të plotësuar** (Deklarimet në pjesën e pasme janë me dëshirë dhe qëndrojnë në inspektoriatin e shëndetësisë. Por ne ju lutemi ti përgjigjeni pyetjeve me kujdes dhe në mënyrë të plotë në mënyrë që ju dhe fëmija juaj të këshillohen sa më mirë të jetë e mundshme.)

Nëse fëmija juaj posedon një **certifikatë për persona me aftësi tepër të kufizuara** ose një **dokument shëndeti** (p.sh. fletore alergjie, certifikatë diabeti) atëherë sillini edhe ato me vete, dhe nëse keni sillni edhe **syzet ose pajisjen e dëgjimit**. Nëse fëmija juaj gjatë 3 muajve të fundit i është nënshtruar një **testi dëgjimi ose shikimi**, mund të sillni me vete një vërtetim nga otorinolaringologu ose okulisti.

(Nëse për arsye legjitime, nuk e keni të mundur ta shoqëroni fëmijën tuaj personalisht në ekzaminimin e pranimit në shkollë, personi shoqërues që keni caktuar, duhet të ketë një prokurë prej jush.)

Ekzaminimi i pranimit në shkollë përfshin së pari tek të gjithë fëmijët skanimit e pranimit në shkollë me kontrolle të shikimit, dëgjimit, të folurit dhe zhvillimit nëpërmjet një punonjësi të kualifikuar të mjekësisë sociale.

Nëse është e nevojshme kësaj i bashkëngjitet edhe një ekzaminim mjekësor me një diagnostikim orientues të zhvillimit. **Nëse fëmija juaj nuk paraqet dëshmi të ekzaminimit U sipas moshës që duhej të bëhej herën e fundit (U8, në shumicën e rasteve U9), patjetër që duhet kryer ekzaminimi nga mjeku i shkollës.** Për këtë arsye kryejeni ju lutem U9 tek pediatri juaj ose tek mjeku juaj i familjes nëse nuk e keni kryer ende.

Kushtoni vëmendje:

Shkollës i duhet paraqitur një vërtetim i inspektoriatit shëndetësor në lidhje me pjesëmarrjen në ekzaminimin e pranimit në shkollë. Paraqitja e fletores së verdhë të ekzaminimeve në shkollë nuk është e domosdoshme! Pjesëmarrja në ekzaminimin e pranimit në shkollë është e detyrueshme në përputhje me nenin 80 fjalia 1 e ligjit të Bavarisë mbi Edukimin dhe Mësimdhënien.

Të dhënat e ekzaminimit të pranimit në shkollë në Bavari vlerësohen në mënyrë statistikore në formë anonime (pa emër dhe adresë). Në këtë mënyrë fitohen informacione të rëndësishme në lidhje me gjendjen aktuale të shëndetit të fëmijëve në Bavari.

Informacione të tjera në lidhje me ekzaminimin e pranimit në shkollë gjeni në fletë-palosjen bashkëlidhur ose në internet (në www.lgl.bayern.de/schuleingangsuntersuchung).

Sinqerisht

Ju lutemi kthejeni nga ana tjetër